

	
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANCËVE-MINISTARSTVO FINANSIJA-MINISTRY OF FINANCE KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR KOSOVSKI SA VET ZA FINANCIIJSKO IZVEŠTAVANJE KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL	
Nr. Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No: 1386
Nr. i faqyes Broj stranica No. pages:	Data Datum Date: 28. 04. 26
PRISHTINË/ PRISHTINA / PRISHTINA	

MEDITECH SH.P.K.

NUI: 810828270

Pasqyrat financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025

dhe

Raporti i Auditorit të Pavarur

Emri biznesit: MEDITECH SH.P.K.



NUI: 810828270

Adresa: Graçanicë, Rruga Marigona Residence, p.n.

Deklaratë e Pajtueshmërisë

- Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2025 -

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

 Arianit Jakupi Drejtor Ekzekutiv		 Mikelina Rodiqi Drejtor Financiar	 Ferdi Salla Kontabilist i çertifikuar
---	--	--	--

Prishtinë, 2026

PËRMBAJTJA:

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	6
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	9
1. Informata të përgjithshme.....	10
2. Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimeve.....	11
3. Politikat materiale kontabël.....	12
4. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit.....	22
5. Instrumentet financiare – menaxhimi i rrezikut.....	23
5. Instrumentet financiare – menaxhimi i rrezikut (vazhdim)	24
6. Prona, pajisjet dhe impiantet	26
7. E drejta e përdorimit të pasurisë.....	27
8. Stokset dhe mallrat.....	27
9. Llogaritë e arkëtueshme tregtare	27
9.1. Provizionet e llogarive të arkëtueshme tregtare	27
10. Pasuritë tjera afatshkurtra.....	28
11. Paraja dhe ekuivalentët e saj.....	28
12. Detyrimi mbi të drejtën e pasurisë	28
13. Llogaritë e pagueshme tregtare.....	29
14. Detyrimet tjera afatshkurtra.....	29
15. Të hyrat nga shitja.....	29
16. Kosto e mallit të shitur	29
17. Të adhurat (shpenzimet) tjera.....	30
18. Shpenzimet e personelit	30
19. Shpenzimet operative dhe administrative	30
20. Shpenzimet dhe të ardhurat financiare	31
21. Shpenzimet e tatimit në fitim.....	31
22. Kontingjencat dhe zotimet	31
23. Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura.....	32
24. Ngjarjet pasuese	32

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin dhe aksionarët e MEDITECH SH.P.K.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Meditech sh.p.k. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2025 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitive financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2025 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF').

Baza për Opinion

Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Ne besojmë se evidenca e përfutur e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

Çështjet tjera

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra financiare më datë 30 prill 2025.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rrezeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përfutur e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfutura deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lekë Musa
Auditor Ligjor



bakertilly
Baker Tilly Kosovo P.K.
Prishtinë

Baker Tilly Kosovo
27 prill 2026

MEDITECH SH.P.K.


PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Me 31 dhjetor 2025

(Shumat e paraqitura në Euro, përveçse ceket ndryshe)

		Me 31 dhjetor 2025 EUR	Me 31 dhjetor 2024 EUR
	Shënimi		
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	6	432,095	282,415
E drejta a përdorimit të pasurisë	7	211,605	200,848
Gjithsej pasuritë afatgjata		643,701	483,263
Pasuritë afatshkurtra			
Stoqet dhe mallrat	8	7,359,416	5,368,591
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	2,299,470	773,489
Pasuritë tjera afatshkurtra	10	342,208	214,464
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	11	3,754,472	3,899,013
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		13,755,565	10,255,557
Gjithsej pasuritë		14,399,266	10,738,820
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali akisonar		20,000	20,000
Fitimet e mbajtura		2,161,558	2,743,950
Gjithsej ekuiteti		2,181,558	2,763,950
DETYRIMET			
Detyrimet afatgjata			
Detyrimi mbi të drejtën e pasurisë	12	179,522	143,611
Gjithsej detyrimet afatgjata		179,522	143,611
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	13	11,902,548	7,662,663
Detyrimi mbi të drejtën e pasurisë	12	48,546	68,607
Detyrimet tjera afatshkurtra	14	87,092	99,989
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		12,038,186	7,831,259
Gjithsej detyrimet		12,217,708	7,974,870
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		14,399,266	10,738,820

Pasqyrat financiare janë përparë dhe aprovuar nga menaxhmenti më 27 prill 2026 nga:


 Arianit Jakupi
 Drejtor Ekzekutiv


 Mikelina Rodiqi
 Drejtor Financiar


 Ferdi Salla
 Kontabilist i çertifikuar

Shënimet e bashkangjitura në faqet 10 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEDITECH SH.P.K.**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE****Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025***(Shumat e paraqitura në Euro, përveçse ceket ndryshe)*

Për vitin që përfundon		Me 31 dhjetor 2025 EUR	Me 31 dhjetor 2024 EUR
	Shënimi		
Të hyrat nga shitja	15	26,708,145	23,225,820
Kosto e mallit të shitur	16	(23,115,417)	(19,555,291)
Fitimi / (humbja) bruto		3,592,728	3,670,529
Të adhurat (shpenzimet) tjera	17	(7,938)	27,813
Shpenzimet e zhvlerësimit	6	(112,223)	(97,870)
Amortizimi i së drejtës të përdorimit të pasurive	7	(54,087)	(64,526)
Shpenzimet e pagave	18	(517,580)	(390,023)
Shpenzimet operative dhe administrative	19	(461,116)	(680,981)
Gjithsej shpenzimet		(1,152,944)	(1,205,586)
Fitimi / (humbja) operative		2,439,783	2,464,943
Të adhurat (kostot) financiare, neto	20	(20,302)	61,302
Fitimi / (humbja) para tatimit		2,419,482	2,526,245
Shpenzimet e tatimit në fitim	21	(257,925)	(267,203)
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit		2,161,557	2,259,041
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit		-	-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		2,161,557	2,259,041

Shënimet e bashkangjitura në faqet 10 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEDITECH SH.P.K.**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET****Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025***(Shumat e paraqitura në Euro, përveçse ceket ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Me 31 dhjetor 2023	20,000	4,431,809	-	4,451,809
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit	-	2,259,041	-	2,259,041
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividentat	-	(3,946,900)	-	(3,946,900)
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2024	20,000	2,743,950	-	2,763,950
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit	-	2,161,557	-	2,161,557
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividentat	-	(2,743,947)	-	(2,743,947)
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	(3)	-	(3)
Me 31 dhjetor 2025	20,000	2,161,558	-	2,181,558

Shënimet e bashkangjitura në faqet 10 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEDITECH SH.P.K.**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË****Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025***(Shumat e paraqitura në Euro, përveçse ceket ndryshe)*

Për vitin që përfundon		Me 31 dhjetor 2025	Me 31 dhjetor 2024
	Shënimi		
AKTIVITETI OPERATIV			
Fitimi / (humbja) neto i/e vitit		2,161,557	2,259,041
<i>Rregullimet për zërat jo-monetarë</i>			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	6	112,223	97,870
Zhvlerësimi i të drejtës së përdorimit të pasurisë		54,087	64,526
Të ardhurat financiare	23	-	(92,255)
Shpenzimet financiare nga lizingu financiar	23	14,324	13,752
Provizionet mbi llogaritë e arkëtueshme	10	14,472	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	24	257,925	267,203
<i>Ndryshimet në neto kapitalin qarkullues</i>			
(Rritja) / zvogëlimi në stoke	9	(1,990,825)	(3,243,951)
(Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	10	(1,540,453)	413,027
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë tjera afatshkurtëra	11	(127,744)	2,018,734
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	14	4,240,303	2,854,050
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet tjera afatshkurtër	15	(12,619)	19,137
Tatimi në fitim i paguar		(258,203)	(267,203)
Interesi financiar bankar i paguar	23	-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		2,925,048	4,403,931
AKTIVITETI INVESTUES			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	6	(261,904)	(25,906)
Interesi i arkëtuar	23	-	92,255
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(261,904)	66,349
AKTIVITETI FINANCUES			
Dividentat e paguara		(2,743,950)	(3,946,900)
Pagesat e lizingut financiar	13	(63,736)	(72,527)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		(2,807,686)	(4,019,427)
Rritja / (zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		(144,541)	450,853
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	12	3,899,013	3,448,161
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		3,754,472	3,899,014

Shënimet e bashkangjitura në faqet 10 deri 31 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MEDITECH SH.P.K.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat në Euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

1. Informata të përgjithshme

MEDITECH SH.P.K. ("Kompania") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.), e regjistruar dhe që operon në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Numri unik identifikues i biznesit është 810828270, ndërsa numri i biznesit është 70959011. Kompania është regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) me datë 16 maj 2013. Statusi i kompanisë në ARBK është Regjistruar.

Adresa e regjistruar e kompanisë është Rruga Marigona Residence, p.n., Komuna Graçanicë, Republika e Kosovës. Numri kontaktues i kompanisë është +383 45 900 947, ndërsa adresa elektronike zyrtare është office@meditech-ks.com. Kapitali i regjistruar i kompanisë është 20,000.00 EUR.

Pronësia mbi kapitalin aksionar të kompanisë

Sipas të dhënave zyrtare të regjistruara në ARBK, kapitali aksionar i MEDITECH SH.P.K. është i shpërndarë si në vijim:

- Stak Staka – 70.00% (14,000 EUR)
- Aranit Jakupi – 10.00% (2,000 EUR)
- Mikelina Rodiqi – 10.00% (2,000 EUR)
- Shkelzen Fetiu – 10.00% (2,000 EUR)

Menaxhmenti

Përfaqësuesi i autorizuar dhe Drejtori Menaxhues i kompanisë është Aranit Jakupi, i emëruar në përputhje me aktet statutore dhe ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Aktiviteti i kompanisë

Aktiviteti kryesor i kompanisë është:

- Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjekësorë, në dyqane të specializuara

Aktivitete të tjera të regjistruara përfshijnë:

- Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore)
- Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë

Numri i punëtorëve:

Gjatë vitit 2025 kompania ka deklaruar mesatarisht 21 punëtorë, ndërsa më 31 dhjetor 2024 ishte mesatarisht 19 punonjës.

MEDITECH SH.P.K.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat në Euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

2. Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimeve

Standardet, interpretimet dhe ndryshimet e reja të standardeve të kontabilitetit të SNRF të miratuara nga 1 janari 2025

Ndryshimet në SNK 21 – Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Huaj: Mungesa e Këmbyeshmërisë

Ndryshimet sqarojnë se si një entitet vlerëson nëse një monedhë është e këmbyeshme në një monedhë tjetër dhe si të përcaktojë kursin e duhur të këmbimit kur këmbyeshmëria mungon përkohësisht. Ndryshimet gjithashtu prezantojnë kërkesa shtesë për shpalosje.

Miratimi i këtyre ndryshimeve nuk pati një ndikim material në pozicionin financiar, performancën financiare ose rrjedhat e parave të gatshme të kompanisë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025.

Standardet e reja dhe të rishikuara të Kontabilitetit SNRF janë publikuar, por ende nuk kanë hyrë në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, kompania nuk ka zbatuar Standardet e mëposhtme të reja dhe të rishikuara të Kontabilitetit SNRF që janë publikuar, por ende nuk kanë hyrë në fuqi:

- Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7 – Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare
- Ndryshimet në SNRF 9 dhe SNRF 7 – Kontratat që Referohen Energjisë Elektrike të Varur nga Natyra
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të Kontabilitetit SNRF – Vëllimi 11
- SNRF 18 – Prezantimi dhe Shpalosja në Pasqyrat Financiare
- SNRF 19 – Filialet pa Përgjegjësi Publike: Shpalosjet

Drejtorët nuk presin që adoptimi i standardeve të listuara më sipër do të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhat e ardhshme.

3. Politikat materiale kontabël

Politikat materiale kontabël të paraqitur në vazhdim janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare, dhe janë aplikuar në vazhdimësi nga entiteti.

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("SNRF") nën konventën e kostos historike. Politikat materiale kontabël të përdorura gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare paraqiten mëposhtë.

3.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rivlerësimit të pasurive të caktuara dhe instrumenteve financiare që maten me shuma të rivlerësuar ose vlera të drejta në fund të çdo periudhe raportuese, siç shpjegohet në politikat e kontabilitetit më poshtë. Kostoja historike zakonisht bazohet në vlerën e drejtë të shumës së dhënë në këmbim të mallrave dhe shërbimeve.

3.3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me "SNRF" kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kritike kontabël. Gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Entitetit. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të shpalosura në Shënimin 4.

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një pasuri ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes, pavarësisht nëse ai çmim është drejtpërdrejt i vëzhgueshëm ose i vlerësuar duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi. Në vlerësimin e vlerës së drejtë të një pasurie ose një detyrimi, Kompania merr në konsideratë karakteristikat e pasurisë ose detyrimit nëse pjesëmarrësit e tregut do t'i merrnin parasysh këto karakteristika kur përcaktojnë çmimin e pasurisë ose detyrimit në datën e matjes.

Vlera e drejtë për qëllime matjeje dhe/ose shpalose në këto pasqyra financiare të përcaktohet mbi një bazë të tillë, me përjashtim të transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione që janë brenda objektit të SNRF 2, transaksioneve të qirasë që janë brenda objektit të SNRF 16 dhe matjeve që kanë disa ngjashmëri me vlerën e drejtë, por nuk janë vlerë e drejtë, siç është vlera neto e realizueshme në SNK 2 ose vlera në përdorim në SNK 36. Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël të caktuara kritike. Gjithashtu, kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Kompanisë.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur thuhet ndryshe.

3.4. Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti, në kohën e miratimit të pasqyrave financiare, kanë një pritje të arsyeshme që Entiteti të ketë burime të përshtatshme për të vazhduar ekzistencën operacionale për një të ardhme të parashikueshme. Kështu që ata vazhdojnë të adoptojnë bazën e vijimësisë të kontabilitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare. Menaxhmenti, pasqyrat financiare përgatiti sipas parimit të vijimësisë.

MEDITECH SH.P.K.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat në Euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

3.5. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Monedha funksionale e Kompanisë është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon entiteti. Monedha funksionale e entitetit dhe monedha e prezantimit është Euro ("EUR"), e cila është monedha ligjore në Republikën e Kosovës.

Në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), EUR është miratuar si monedhë e vetme ligjore në territorin e Kosovës nga 1 janari 2002.

3.6. Transaksionet dhe balancat në monedha tjera

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të Kompanisë, transaksionet në monedha të ndryshme nga monedha funksionale e entitetit (valutat e huaja) njihen me kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, pasuritë dhe detyrimet monetare që janë të shprehura në valuta të huaja ripërkthen me normat mbizotëruese në atë datë. Zërat jomonetarë të mbartur me vlerën e drejtë që janë të shprehur në valutë të huaj përkthehen me normat që mbizotërojnë në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jomonetarë që maten në terma të kostos historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen.

3.7. Prona, impiantet dhe pajisjet

i) Njohja dhe matja

Prona dhe pajisjet janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe minus humbjet nga dëmtimi i aseteti, nëse ka. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së artikujve. Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të aseteve ose njihen si një aset i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera njihen në Fitim ose humbje në momentin kur ndodhin. Kur pjesët e një artikulli të pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato llogariten si ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pronës dhe pajisjeve. Softueri i blerë i cili është kyç për funksionalitetin e pajisjeve kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje. Fitimet dhe humbjet nga heqja prej përdorimit të pronave, impianteve dhe pajisjeve përcaktohen duke krahasuar të ardhura nga largimi apo shitja me vlerën kontabël të pasurisë më datë, dhe ato njihen si fitim apo humbje kapitale.

ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese përshihen në vlerën kontabël të aktivit ose njihen si aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me artikullin do të rrjedhin tek Entiteti dhe kostoja e artikullit mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtja e përditshme shpenzohen kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose komponentëve të pronave dhe pajisjeve kapitalizohet dhe pjesa e zëvendësuar largohet nga llogaritja.

Në fund të çdo date të raportimit, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues për dëmtim të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një asemi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim.

Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi (dëmtimi) njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga rënia në vlerë (dëmtimi) e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e heqjes nga përdorimi.

MEDITECH SH.P.K.

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat në Euro, përveç nëse shprehet ndryshe)

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

3.7. Prona, impiantet dhe pajisjet (vazhdim)

iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet mbi shumën e zhvlerësueshme, që është kostoja e një aktivi, ose shuma tjetër që e zëvendëson atë, zvogëluar (minus) vlera saj e mbetur deri më datë. Përpos aktivieve tjera, toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i zërave të tjerë të pronës, impianteve dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetëgjatësisë së tyre të vlerësuar:

	Jetë të dobishme në vite
Ndërtesat	20 vite
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vite
Automjete	5 vite
Pasuri tjera të trupëzuara	10 vite
Përmisimet e qirasë	Më e shkurtëra mes jetës së dobishme dhe afati i qirasë themelore

Vlera e mbetur e një asemi është vlera e parashikuar që Kompania aktualisht do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e asetit minus koston e vlerësuar të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse asemi ishte tashmë në moshë dhe në gjendje që pritet të jetë në fund të jetës së saj të dobishme.

Vlerat e mbetura të aseteve dhe jetët e dobishme rishikohen, dhe korrigjohen nëse është e përshtatshme, në fund të çdo periudhe raportuese.

3.8. Pasuritë e paprekshme

i) Njohja dhe matja

Pasuritë e patrupëzuara të cilat janë blerë nga Entiteti, maten me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi, nëse ka.

ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të materializuara në një pasuri specifike me të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera duke përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe markën, njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, në momentin e ndodhjes.

iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e pasurisë apo aktivitetit minus vlera e mbetur. Amortizimi është njohur në pasqyrën e të ardhurave apo humbjes gjithpërfshirëse duke përdorur metodën lineare për programet kompjuterike, me një normë amortizimi vjetor prej 20%.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

3.9. Stoqet

Stoqet paraqiten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe, aty ku është e aplikueshme, kostot direkte të punës dhe ato shpenzime të përgjithshme që janë shkaktuar për të sjellë stoqet në vendndodhjen dhe gjendjen e tyre aktuale. Kostoja llogaritet duke përdorur metodën e kostos mesatare të ponderuar. Vlera neto e realizueshme përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes minus të gjitha kostot e vlerësuar të përfundimit dhe kostot që do të ndodhin në marketing, shitje dhe shpërndarje.

3.10. Instrumentet financiare

Njohja dhe çregjistrimi. Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar. Pasuritë financiare çregjistrohen kur të drejtat e kontratës për rrjedhat e parave nga pasuria financiare skadojnë, ose kur pasuria financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare. Me përjashtim të atyre të arkëtueshmeve tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi dhe që maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të korrigjuar për kostot e transaksionit (kur është e aplikueshme).

Pasuritë financiare, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto e amortizuar
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura, kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si FVOCI.

Klasifikimi përcaktohet nga të dy:

- modeli i biznesit të entitetit për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat kontraktuale të rrjedhës së parave të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me pasurinë financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda kostove të financimit, të ardhurave nga financimi ose zërave të tjerë financiarë, përveç dëmtimit të llogarive të arkëtueshme tregtare, i cili paraqitet brenda shpenzimeve të tjera.

Matja pasuese e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar. Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk përcaktohen si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare dhe të mbledhë rrjedhat kontraktuale të parasë
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktojnë rrjedha të parasë që janë vetëm pagesa të principalit dhe kamatës mbi shumën kryesore të mbetur.

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Skontimi shmanget kur efekti i skontimit është jomaterial. Paraja dhe ekuivalentët e parave të kompanisë, llogaritë e arkëtueshme dhe shumica e të arkëtueshmeve tjera hyjnë në këtë kategori instrumentesh financiare, si dhe obligacione të listuara që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim nën SNK 39.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)**Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)**

Pasuritë financiare që mbahen brenda një modeli biznesi të ndryshëm përveç "mbajtjes për të mbledhur" ose "mbajtjes për të mbledhur dhe shitur", kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, rrjedhat e parasë kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative hyjnë në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilat aplikohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Kompania trajton pasuritë financiare në FVOCI nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen nën një model biznesi, objektivi i të cilit është "mbajtje për të mbledhur" dhe shes rrjedhat përkatëse të parave
- Kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktjnë rrjedha të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

Çfardo fitimi ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas çregjistrimit të aktivit.

Dëmtimi i pasurive financiare. Kërkesat e SNRF 9 për zhvlerësimin të përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kredisë - modeli "i humbjes së pritshme të kredisë (ECL)". Kjo zëvendësoi "modelin e humbjes së shkaktuar" të SNK 39. Instrumentet brenda objektivit të kërkesave të reja përfshijnë kredi dhe aktive të tjera financiare të llojit të borxhit të matur me kosto të amortizuara dhe FVOCI, arkëtime tregtare, asete kontrate të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e kredisë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) që janë nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Njohja e humbjeve të kredisë nuk varet më nga kompania që së pari të identifikoj një ngjarje të humbjes së kredisë. Përkundrazi, kompania merr në konsideratë një gamë më të gjerë informacioni kur vlerëson rrezikun e kredisë dhe matë humbjet e pritura të kredisë, përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në mbledhjen e pritshme të rrjedhave të ardhshme të parave të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasje që shikon përpara, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiarë që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët kredie ("Faza 1") dhe
- instrumente financiarë që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ("Faza 2").

"Faza 3" do të mbulojë pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të dëmtimit në datën e raportimit "12-muajt e pritshme të humbjes së kredisë", njihen për kategorinë e parë, ndërsa "humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës" njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritura të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar i mundshëm i humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Të arkëtueshmet dhe pasuritë e kontraktuara. Kompania përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilitetin e të arkëtueshmeve, si dhe pasuritë kontratës dhe regjistron lejimin e humbjes si humbje të pritshme të kredisë. Këto janë mangësitë e pritura në rrjedhat kontraktuale të parasë, duke marrë parasysh potencialin e mospagimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Në llogaritjen, kompania përdor përvojën e tij historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritura të kredisë duke përdorur një matricë provizionit.

Kompania vlerëson dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare në bazë kolektive pasi ato posedojnë karakteristika të rrezikut të përbashkët të kredisë për të cilët ata janë grupuar bazuar në ditët e kaluara.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare. Detyrimet financiare të kompanisë përfshijnë huazime, të pagueshme tregtare dhe të tjera dhe instrumente financiare derivative. Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, dhe, kur është e përshtatshme, rregullohen për kostot e transaksionit, përveç nëse kompania caktoi një detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç për derivatet dhe detyrimet financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat barten më pas në vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës).

Të gjitha tarifat që lidhen me interesin dhe, nëse është e aplikueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje, përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

Kompensimi i instrumenteve financiare: Asetet dhe detyrimet financiare kompensohen në mes veti dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë asetin dhe zgjidh detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme kontingjente dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast të dështimit dhe (iii) në rast të falimentimit.

3.11. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në dorë, depozitat e mbajtura në thirrje me bankat dhe investime të tjera afatshkurtra shumë të lëngëta me maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar sepse: (i) janë mbajtur për arkëtimin e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe (ii) ato nuk janë të përcaktuara në FVTPL. Karakteristikat e mandatuara vetëm nga legjislacioni, siç është legjislacioni për lirin me kusht në vende të caktuara, nuk kanë ndikim në testin e SPPI, përveç nëse ato janë të përfshira në terma kontraktuale në mënyrë që funksioni të zbatohet edhe nëse legjislacioni më vonë ndryshohet.

3.12. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe mbahen më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.13. Parapagimet

Parapagimet kryhen me kosto minus provigjionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritët të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aset që vetë do të klasifikohet si jo-qarkullues pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aseteve transferohen në vlerën kontabël neto të asetit sapo Kompania ka marrë kontrollin e asetit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me asetin do të rrjedhin në Kompani. Pagesat paraprake të tjera shlyhen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se asetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të pranohen, vlera bartëse e parapagimit shënohet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje për vitin.

3.14. Të pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare përfaqësojnë detyrimet afatshkurta të kompanisë për mallrat dhe shërbimet e marra nga furnitorët në periudhën e raportimit dhe që janë të paguara në fund të periudhës. Llogaritë e pagueshme regjistrohen fillimisht në vlerën e drejtë, e cila zakonisht është e barabartë me vlerën e faturës së furnitorit, dhe më pas ato mbahen sipas koston e amortizuar. Llogaritë e pagueshme janë të pasiguruara dhe zakonisht shlyhen brenda afatit të rënë dakord me furnitorët. Nëse ndonjë detyrim paguhet me vonësë, kompania mund të jetë e detyruar të paguajë interes ose penalitete, të cilat regjistrohen veçmas si shpenzime financiare.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

3.15. Huazimet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit të ndodhura dhe mbahen më pas në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.16. Garancitë financiare.

